

L. PORADECI – Vdekja e nositit

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

*Me zjarr u flas... me zjarr.
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë-edhe t'ja marr...*

Cilës vetë i drejtohet poeti që në vargun e parë? Pse e bën ai këtë?

Gjeni antonimet, antonimet kontekstuale dhe shpjegojini ato.

Shpjegoni ritmin e strofës.

*Un'ik liqerit zemërak
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak.*

Ç'kuptim ka fjala zemërak?

Gjeni elementë që të mbështetni mendimin se Lasgushi është romantik i vonë.

Komentoni gjendjen që sugjerojnë dy vargjet e fundit të strofës. Si arrihet të krijohet kjo gjendje?

-shënime-

Fjala *fatlum* duket sikur nuk shkon me gjendjen shpirtërore të srofës (vdekja e pritshme etj.).

Si mund ta justifikojmë praninë dhe mospërputhjen e kësaj fjale?

*Se vijnë urtuar zogjt-e mi.
Dh'u jap ushqim me dashuri-
Një dashuri për llaftari.*

Shpjegoni në dy plane urinë dhe ushqimin që përmenden në këtë strofë.

Gjeni një nga tiparet më të qenësishme të dashurisë së Lasgushit.

*Pa nis ah! gjirin ta godas...
Dh'e hap ah! gjirin më një ças...
Dh'i nginj ah! zogjtë-e vdes me gas!*

Cila është ideja bazë e gjithë poezisë, sipas kësaj strofe?

Ç'kuptim ka pasthirrma ah! e vendosur në mes të çdo vargu të strofës?

Pse poeti-nosit i poezisë vdes me gas? Çfarë e bën vdekjen e tij të lumtur?

-shënime-

Ahere helmohet e buçet
 Pas mallit tim liqer-i shkret,
 E rrit tallazin porsì det.

Ç'është malli në konceptin lasgushian?

Ç'tregon paralelizmi i gjendjes shpirtërore me natyrën/liqenin? Pse shpirtëzohet liqeni?

Ay e tund, ay e shkund,
 Ay e hap sa me të mund,
 Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.

Gjeni idenë që përçon ritmi i kësaj strofe.

Në këtë strofë kemi përsëritje si veprim, si anaforë dhe paralelizim. Gjejini ato.

Fjala *fund* shpreh fundin e liqenit apo ka kuptim më të gjerë?

E shpirtin dyke ma përcjellë,
 Më thotë ah! shih sesa 'sht'i fellë
 Ky gjir'i im që të pat pjellë...

Çfarë shënon përfundimisht kjo strofë?

A ndihet dhimbje në këtë strofë?

-shënime-

Poezia nis e mbyllet me të njëjtin varg. Çfarë efekti krijon kjo dhe si mund të motivohet?

Cila është atmosfera që mbizotëron në këtë poezi, pesimizmi apo optimizmi?